



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 5, Datë 27.05.2014

P Ë R

ZHVILLIMET ME INTERES PUBLIK, SHTETËROR DHE KOMBËTAR NË ZONAT E PEZULLUARA ME VENDIM TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 6, 8 dhe 64, pika 3, të Ligjit nr. 10 119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, si dhe në vijim dhe zbatim të Vendimit nr. 1, datë 08.10.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të planit të integruar sektorial për brezin bregdetar”, të Vendimit nr. 3, datë 18.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonën me rëndësi të veçantë të kurorës së Tiranës”, të Vendimit Nr. 4, datë 18.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në zonat me rëndësi kombëtare mjedisore”, të Vendimit nr. 5, datë 18.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Lejet zhvillimore në zonat e pezulluara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, që kanë të miratuar Instrumentin e Përgjithshëm Vendor, mund të jepen nga autoritetet e planifikimit për zhvillime me interes publik, kombëtar dhe shtetëror, pasi të jetë shprehur më parë AKPT-ja, dhe duke vënë në dijeni KKT-në, për përputhshmërinë e zhvillimit të propozuar me instrumentet kombëtare të planifikimit, të miratuara ose në proces.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, të hartojë procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohen autoritetet e planifikimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE EKKT

EGLANTINA GJERMENTI




MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

